VENDIM
Nr. 926, datë 25.11.2020

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2020 NDËRMJET MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e vitit 2020, në programin "Përkujdesja sociale", në artikullin 606, i shtohet fondi prej 2 000 000 000 (dy miliardë) lekësh.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga pakësimi i fondeve korrente për disa ministri dhe institucione buxhetore, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të gjitha ministritë/institucionet buxhetore, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr. 1

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Vlera në mijë lek e pakësimit
2	**Kuvendi**	**56,000**
01120	Veprimtaria ligjvënëse	56,000
3	**Kryeministria**	**43,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	43,000
5	**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	**57,900**
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	34,400
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	23,500
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**	**355,000**
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	255,000
10550	Tregu i punës	100,000
12	**Ministria e Kulturës**	**21,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	4,000
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	11,000
08230	Arti dhe kultura	6,000
13	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**	**402,100**

01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	41,800
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	190,500
07450	Shërbimet e shëndetit publik	141,000
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	28,800
14	**Ministria e Drejtësisë**	**20,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	20,000
16	**Ministria e Brendshme**	**224,000**
03140	Policia e Shtetit	224,000
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**367,000**
02120	Forcat e Luftimit	234,000
02150	Mbështetja e luftimit	100,000
10910	Emergjencat Civile	33,000
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**110,000**
03520	Veprimtaria informative shtetërore	110,000
26	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	**63,000**
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	33,000
04260	Administrimi i pyjeve	30,000
29	**Këshilli i Lartë i Gjyqësor**	**150,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	10,000
03310	Buxheti gjyqësor	140,000
41	**Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**	**34,000**
03390	Veprimtaria e SPAK-ut	34,000
50	**Instituti i Statistikës**	**60,000**
01320	Veprimtaria statistikore	60,000
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**12,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	12,000
87	**Institucione të tjera qeveritare**	**25,000**
01140	*e-Qeverisja*	25,000
	TOTALI	**2,000,000**

2,000,000